

**11-13** Kosova shënon “Ditën Botërore të Kursimeve”

**14** Depozitat kontribuese të stabilitetit bankar

# IBANK

Nëntor 2018 | Nr. 16 - Gratis



**Balija: Edukimi financiar, mundësi e mirë për ta luftuar varfërinë**

FAQE 07

## ZHVILLIMI NGA KURSIMET

Mbi 2.2 miliardë euro i mbajnë të kursyera në banka komerciale ekonomitë familjare në Kosovë. Kursimet familjare po shënojnë rritje nga viti në vit, të cilat përveç që gjenerojnë kthime pozitive nga interesi në depozita, shërbejnë edhe për financim të aktivitetit kreditor nga institucionet financiare në vend.

FAQE 03

## Mësimet për fëmijët në Ditën Botërore të Kursimit

FAQE 02



# Mësimet për fëmijët në Ditën Botërore të Kursimit

**N**ë disa vende të botës, Dita Botërore e Kursimeve është gjithmonë një ditë me entuziazëm të madh, kur bankat shpërndajnë “banka kursimi” për fëmijët pa pagesë, dhe i frymëzojnë ata për të vendosur qëllime kursimi, duke e futur një ndjenjë të përgjegjësisë financiare në mendjen e tyre të re. Menaxhimi i financave personale është një aftësi e madhe për jetën në çdo moshë. Fëmijët të cilët mësohen që të jenë të përgjegjshëm financiarisht, përgjithësisht janë më të pajisur me dije që më vonë në jetën e tyre të marrin vendime më të mira financiare, si dhe për të krijuar zakone të mira kursimi. Më poshtë janë paraqitur disa mënyra për t’i nxitur fëmijët tuaj që të kursejnë, duke filluar nga 31 tetori, me disa aktivitete të Ditës Botërore të Kursimeve, kampanjë e cila do të sjellë përfitime të mëdha për ta.

## INKURAJONI FËMIJËT TUAJ QË TË KENË NJË “ARKË KURSIMESH” PËR KURSIME

Ne rekomandojmë t’i inkurajoni fëmijët tuaj që të përdorin arkën e kursimeve duke i futur paratë nga kapaku. Kjo do të shërbejë për qëllime të shumëfishta. Fëmijët tuaj do të kënaqen duke futur para të kursyera apo paratë e xhepit në “bankat” e tyre. Mund të jetë nxitje vizuale për ta se sa para po grumbullohen. Ajo do të sjellë shprehje të mirë të kursimit në mendjen e fëmijës. Megjithatë fëmija juaj është kandidat i vogël, mund të hapni llogari bankare kursimi në emrin e fëmijës suaj. Kërkojini fëmijës tuaj që të shkoni me të dhe të kaloni ca kohë në bankën, për të bërë një depozitë të vogël simbolike, si p.sh. 5 euro çdo muaj në këtë llogari. Kjo i mban të motivuar ata për të ndërtuar një bilanc të mirë të llogarisë bankare,

përveç depozitimit të parave në arkën e kursimeve. Ua mësoni atyre financat përmes lojërave. Lojërat janë mënyra më e mirë për t’i mësuar fëmijët. Për t’ua mësuar financat ju mund të shkoni me të njëjtin koncept, duke luajtur lojëra që lidhen me financat. Lojëra si koncepti “Biznesi i Ri”, lojë që merret me paratë, do t’i ndihmojë fëmijët të kenë vëmendje mbi financat.

## MËSOJUNI ATYRE SE REDUKTIMI I SHPENZIMEVE I BËN QËLLIMET TË REALIZOHEN MË SHPEJT

Vendosni qëllimet para fëmijës suaj dhe mësoni se si t’i arrijnë ato, nëse i mësoni ato për qëllime kursimi, ata ndoshta do ta mësojnë këtë mësim vetë. Është një koncept tashmë i njohur dhe fëmijët janë mjaft të zgjuar për t’i kuptuar: nëse dëshiroj të arrij një qëllim më shpejt, duhet të kursej më shumë ... që do të thotë të shpenzojsh më pak në gjëra të tjera. Gjithashtu, ia vlen të përforcohet kjo me ndonjë diskutim rreth shpenzimeve dhe kursimeve, por edhe duke folur me ta për shpenzimet që ata bëjnë çdo herë.

## MËSONI ATA SE SI PARATË TUAJA MUND TË BËJNË PARA TË TJERA

Mësoni fëmijën tuaj se paratë e vendosura në arkën e kursimeve, nuk do të rriten, por paratë e vendosura në llogarinë bankare të kursimeve do të fitojnë kamatë dhe do të rriten. Mësoni ata rreth investimeve dhe tregojuni atyre se si mund t’i investojnë paratë në investime të caktuara dhe se si ato investime do të rriten me kalimin e kohës.

## MËSONI FËMIJËT SE ÇFARË ËSHTË BUXHETI

Mësojini fëmijët tuaj se çfarë do të thotë buxheti, duke i dërguar

në një nivel që ata do ta kuptojnë. Ndoshta ata kërkojnë të hanë drekë në restorant, dy apo tre ditë në javë? Vendoseni një buxhet për paratë e drekës dhe ua dëshmoni atyre se si shpenzimet më të vogla do t’i shtojnë kursimet. Në fund të fundit, paratë e kursyera janë paratë që fitojnë.

Këtë bëjeni të thjeshtë dhe të lehtë, kështu që ata nuk rriten duke menduar se buxhetet janë të vështira dhe të rënda (ashtu si shumë prej nesh u rriten duke menduar). Nëse ata e adaptojnë këtë shprehje tani, do të kenë përfitime të mëdha kur të rriten.

## MËSOJINI ATA PËR RREZIQET E BORXHIT

Ky ndoshta nuk është një mësim që ata mund ta kuptojnë kur janë 6 vjeç, por kur ata janë adoleshentë, duhet ta kuptojnë këtë koncept. Duhet të diskutoni gjëra të tilla si: kreditë, kartat e kreditit dhe borxhet e tjera.

## MËSONI ATA SE FITIMI I MË SHUMË PARAVE I ÇON ATA MË AFËR QËLLIMEVE TË TYRE

Nëse keni qëllime kursimi, ju mund t’i reduktoni shpenzimet tuaja për t’i arritur ato më shpejt dhe po ashtu mund të fitoni më shumë para. Ata mund të fillojnë ta mësojnë këtë mësim që nga mosha e hershme, duke fituar para ekstra. Ata mund ta bëjnë këtë duke bërë një punë të vogël kohë pas kohe.

Me një imagjinatë të vogël dhe shumë përforsime pozitive, fëmijët tuaj shumë shpejt mund të jenë në rrugën e duhur që të bëhen financiarisht të përgjegjshëm dhe të mësojnë mësimet jetësore të cilat do t’i vlerësojnë gjatë tërë jetës së tyre. Prandaj, më 31 tetor, derisa u jepni sheqerka fëmijëve tuaj, mos harroni t’u jepni edhe disa këshilla të mira kursimi.

(MONEY EXCEL)



# Zhvillimi nga kursimet

Mbi 2.2 miliardë euro i mbajnë të kursyera në banka komerciale ekonomitë familjare në Kosovë. Kursimet familjare po shënojnë rritje nga viti në vit, të cilat përveç që gjenerojnë kthime pozitive nga interesi në depozita, shërbejnë edhe për financim të aktivitetit kreditor nga institucionet financiare në vend.

Familjet kosovare i kanë mbi 2.2 miliardë euro të kursyera, mjete këto që i mbajnë në dhjetë banka komerciale që operojnë në vend. Kursimet e qytetarëve, përpos rritjes së sigurisë financiare, vlerësohet se janë qenësore edhe për përf forcimin financiar të secilit vend, pasi që përveç që gjenerojnë kthime pozitive nga interesi në depozita, shërbejnë edhe për financim të aktivitetit kreditor nga institucionet financiare në vend. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) bën të ditur se gjatë vitit të kaluar në sistemin bankar depozitat e ekonomive familjare kanë shënuar rritje vjetor prej 2.8 përqind, përderisa depozitat e bizneseve janë rritur

për rreth 13.8 përqind. Depozitat e përgjithshme në sektorin bankar të Kosovës tashmë kanë arritur në rreth 3.2 miliardë euro, përmes së cilave garantohet edhe një kreditim i qëndrueshëm nga bankat.

**Përfitimet nga kursimet**

Sokol Havolli, zëvendësguvernator i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), duke folur për rëndësinë e kursimeve thotë se kjo në radhë të parë është veprim individual për të rritur sigurinë financiare të individëve apo familjeve, dhe rrjedhimisht për të pasur mbrojtje nga ndonjë goditje në burimet e financimit, qoftë humbja e vendit të punës, apo rënia e të ardhurave


nga biznesi.

Megjithatë, sipas Havollit, përveç aspektit të sigurisë financiare individuale, kursimet në institucionet financiare janë qenësore për përf forcimin e sektorit financiar të secilit vend. “Prandaj, kursimet janë qenësore edhe për sistemin financiar në Kosovë, pasi që përveç që mund të gjenerojnë kthime pozitive nga interesi në depozita, po ashtu shërbejnë edhe për financim të aktivitetit kreditor nga institucionet financiare në vend”, shprehet Havolli.

# 3.2 MILIARDË EURO

KA ARRITUR SHUMA E PËRGJITHSHME  
E DEPOZITAVE NË SEKTORIN BANKAR TË KOSOVËS.

# 2.2 MILIARDË EURO



JANË DEPOZITA TË EKONOMIVE FAMILJARE  
NË BANKAT KOMERCIALE.

# 2.8%

KANË SHËNUAR RITJE DEPOZITAT  
E EKONOMIVE FAMILJARE GJATË  
VITIT TË KALUAR.

# 50%

E PRODUKTIT TË BRENDSHËM BRUTO JANË DEPOZITAT, PËRQINDJE  
KJO QË ËSHTË POTHUAJSE E PËRAFËRT ME VENDET E RAJONIT



### VIJONGA FAQJA 03

Ai ka shtuar se tanimë evidenca shkencore tregon në mënyrë të qartë se sistemi financiar i zhvilluar në një vend është faktori kryesor në rritjen ekonomike, gjenerimin e vendeve të punës dhe përfundimisht, ndikon në cilësinë apo standardin e jetës së qytetarëve të atij vendi.

### HAVOLLI: SISTEMI BANKAR NË DITËT MË TË MIRA

Numri dy i BQK-së konstaton se sistemi bankar vendor gjendet në ditët më të mira të tij.

Sipas tij, rritja e kredive në vitin 2017 ka qenë në normën prej 11.4%, ndërsa deri në gusht të vitit 2018 rritja është në normën prej 11.9%. “Aktualisht vlera e përgjithshme e kredive në treg është mbi 2.6 miliardë euro. Në anën tjetër, depozitat tanimë kanë arritur vlerën prej 3.2 miliardë euro dhe norma e rritjes së tyre ishte me 6.8% në vitin 2017 dhe 6.4% deri në gusht të vitit 2018”, thotë Havolli.

Ai ka shtuar se kreditë e sistemit bankar financojnë aktivitete ekonomike, të cilat gjenerojnë vende të reja të punës dhe avancim të biznesit në vend. “Po ashtu, nëpërmjet rritjes së depozitave në sistemin bankar vendor nënkuptohet edhe rritje e mundësisë së financimit nga sistemi bankar për qytetarët për çfarëdo nevojë që mund të kenë, qoftë për konsum, apo investimet e tyre,

përfshirë këtu edhe në hapësira rezidenciale”. Me qëllim të zgjerimit të ndërmjetësimit financiar, tanimë në sistemin financiar të Kosovës është funksional edhe Fondi për Garanci Kreditorë, i cili ka mundësuar që industria financiare të ketë instrumente shtesë për siguri të financimit. Po ashtu, tanimë është funksional edhe Fondi për Garantim të Depozitave, i cili krijon parakushte të mjaftueshme që qytetarët të kenë motiv të mëtejshëm për të rritur depozitat, e në anën tjetër, edhe sistemi financiar të thellojë ndikimin pozitiv në ekonomi.

### DEPOZITAT, 50 PËRQIND E PRODHIMIT TË BRENDSHËM BRUTO

Sipas zyrtarëve të Bankës Qendrore, depozitat janë të afateve të ndryshme, varësisht se si është vlerësuar nga qytetarët edhe interesi i tyre rreth afatizimit. “Megjithatë, pjesa dërmuese i takojnë kategorisë së depozitave të transferueshme, por se

kjo nuk paraqet ndonjë shqetësim për funksionimin e vazhdueshëm të sistemit financiar, pasi që

**“EKONOMITË FAMILJARE E KANË TË PAMUNDUR TË BËJNË INVESTIME NË RENOVIME TË BANIMIT, BLERJE TË PATUNDSHMËRISË, APO EDHE NË SIGURIMIN E EDUKIMIT CILËSOR TË FËMIJËVE PA KRIJUAR NJË BAZË TË KURSIMEVE”, KA THËNË BALIJA**

njëra ndër specializimet e industrisë bankare është pikërisht përshtatja e mos-përputhjes eventuale të maturitetit të depozitave”, thotë zëvendësguvernatori Havolli.

Duke i bërë krahasimet me vendet e rajonit, ai thotë se në përgjithësi, ndërmjetësimi financiar në Kosovë mund të konsiderohet se është për një dozë më të ulët se në vendet e rajonit, por se ky tregues, siç thotë ai, më shumë është aktual sa i përket kredive. “Sa u përket depozitave, të dhënat tregojnë se në Kosovë depozitat

si përqindje e Produktit të Brendshëm Bruto janë afër 50%, figurë kjo e cila konsiderohet se është duke iu afruar shifrave të vendeve të rajonit”.

### JANË RRRITUR SHUMË DEPOZITAT E NDËRMARRJEVE

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2017

Pjesa dërmuese i takojnë kategorisë së depozitave të transferueshme, por se kjo nuk paraqet ndonjë shqetësim për funksionimin e vazhdueshëm të sistemit financiar, pasi që njëra ndër specializimet e industrisë bankare është pikërisht përshtatja e mospërputhjes eventuale të maturitetit të depozitave”, thotë zëvendësguvernatori Havolli

depozitat u rritën për 6.8 përqind më shumë se në vitin paraprak. Depozitat e ndërmarrjeve ishin për 13.8 përqind më të larta krahasuar me vitin e kaluar. “Rritje më të theksuar shënuan depozitat e transferueshme, mirëpo për dallim nga ekonomitë familjare, rritje shënuan edhe depozitat e kursimit të ndërmarrjeve. Norma mesatare e interesit për ndërmarrjet është më e lartë për 1.7 përqind, kundrejt atyre për ekonomitë familjare që kishin një normë prej 1 përqind, thuhet në raportin e Stabilitetit Financiar të BQK-së, të botuar në shtator 2018, duke shtuar se stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti në 2.2 miliardë euro. “Pjesa më e madhe e tyre ishin depozita të transferueshme (38.4 përqind), të cilat me rritjen e tyre vjetore prej 6.8 përqind kontribuuan në rritjen e përgjithshme të depozitave të ekonomive familjare”, thuhet mes tjerash në këtë raport. –

#### EDUKIMI PËR RËNDËSINË E KURSIMEVE

Në kuadër të programeve për edukim financiar të BQK-së është edhe vetëdijësimi i publikut lidhur me rëndësinë e kursimeve është synim të cilin ata synojmë ta arrijmë. Sipas Havollit, përveç ndikimit ekonomik, kursimi, sidomos në instrumente të sistemit bankar, është pozitiv për qytetarin për shkak se mund të konsiderohet si investim, por mbi të gjitha, është edhe siguri në kontekst të ndonjë goditje ekonomike, si p.sh. humbja e vendit të punës, apo rënia e biznesit e të ngjashme. Megjithatë, sipas tij, kursimi dhe depozita janë mënyra të mirë që qytetarët të mbrohen nga dëmtimi eventual fizik që mund t'i shkaktohet pasurisë së tyre të ruajtur në bankënota, por po ashtu edhe nga rreziqet tjera, si p.sh. humbja fizike e parave, vjedhja apo çfarëdo rreziku tjetër që mund të ballafaqohen qytetarët. Gjithashtu, deponimi i mjeteve në sistemin financiar siguron qytetarin se pasuria e tyre është e përfituruar në mënyrë të ligjshme dhe të pakontestueshme.

#### BALIJA: KULTURA E KURSIMEVE, JETIKE PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, thotë se është pothuajse e pamundur që një ekonomi familjare apo shtet të zhvillohet vetëm në bazë të konsumit, pa pasur edhe investime. Ndërsa, parakusht për investime, sipas tij, janë kursimet.

“Ekonomitë familjare e kanë të pamundur të bëjnë investime në renovime të banimit, blerje të patundshmërisë, apo edhe në sigurimin e edukimit cilësor të fëmijëve pa krijuar një bazë të kursimeve”, ka thënë Balija. Ai ka shtuar se përveç të ardhurave që gjenerojnë, ekonomitë familjare mund t'i realizojnë qëllimet e tyre edhe përmes marrjes së kredive bankare. “Por, edhe për të marrë kredi në shumë raste kërkohet që një pjesë e investimit të bëhet nga huamarrësi me mjete vetanake. Do të thotë që kursimet, siç e theksova më lart, janë parakusht për investime”, ka sqaruar Balija.

Sipas tij, ngjashëm është edhe në rastin e zhvil-

# 13.8 %

## JANË RRITUR DEPOZITAT E BIZNESEVE GJATË VITIT TË KALUAR.

limit ekonomik të një vendi, ku kreditë që bankat u japin bizneseve për ta zgjeruar veprimtarinë e tyre dhe për ta rritur punësimin, e kanë bazën në depozitat e qytetarëve të atij vendi. “Prandaj, mund të krijohet edhe korrelacioni që sa më shumë kursime që të kenë qytetarët e një vendi, aq më shumë do të mund të financohet ekonomia e atij vendi”.

Koncepti i tillë, sipas drejtorit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, vlen edhe për investimet qeveritare, të cilat bëhen në saje të kursimeve që qeveria arrin të bëjë në fusha tjera, si pagat dhe mëditjet, apo shpenzime tjera administrative, të cilat kursime pastaj barten dhe alokohen për investime kapitale duke krijuar progres për vendin. “Kultura e kursimeve mund të themi që është jetike për një të ardhme më të mirë të gjithsecilit”, ka theksuar ai.

#### MAZREKU: KRIJIMI I KULTURËS SË KURSIMEVE TË JETË PJESË E KURRIKULËS SË SISTEMIT ARSIMOR

Ibish Mazreku, prorektor në Universitetin publik “Haxhi Zeka” në Pejë thotë se shënimi i ditës botërore të kursimeve edhe te ne është një aktivitet simbolik vetëm në përkujtim të kësaj dite.

“Ndërsa, krijimi i kulturës së kursimeve nga qytetarët tanë është ende për tu dëshiruar. Krijimi i kësaj kulture shkon bashkë edhe me edukimin financiar të qytetarëve. Krijimi i kulturës së kursimeve duhet të jetë pjesë e kurrikulës së sistemit arsimor të Kosovës, e sidomos në nivelet e arsimit parauniversitar. Kjo kulturë ka qenë shumë më e shprehur në të kaluarën sesa tani.

Vetëdijësimi i qytetarëve për rëndësinë e kursimeve është shumë i rëndësishëm si për individët, familjet, ekonominë në tërësi”, ka thënë Mazreku.

Sipas tij, efekti i kursimeve te familjet do të jetë shumë i rëndësishëm në përmirësimin e mirëqenies së tyre në një anë dhe në anën tjetër këto kursime nëse futen në sistemin financiar gjegjësisht në atë bankar krijohen fonde të cilat mund të orientohen drejt aktiviteteve tjera të


“Ndërsa, krijimi i kulturës së kursimeve nga qytetarët tanë është ende për tu dëshiruar. Krijimi i kësaj kulture shkon bashkë edhe me edukimin financiar të qytetarëve. Krijimi i kulturës së kursimeve duhet të jetë pjesë e kurrikulës së sistemit arsimor të Kosovës, e sidomos në nivelet e arsimit parauniversitar. Kjo kulturë ka qenë shumë më e shprehur në të kaluarën sesa tani. Vetëdijësimi i qytetarëve për rëndësinë e kursimeve është shumë i rëndësishëm si për individët, familjet, ekonominë në tërësi”, ka thënë Mazreku

rëndësishme ekonomike të cilat krijojnë investime të reja, vende të lira pune etj.

“Kursimet si mjete të lira përmes sistemit financiar dërgohen tek individët, apo bizneset të cilat kanë nevojë për fonde investive. Kur flasim për kursime duhet të kemi parasysh të gjitha ato kursime të cilat mbahen në sistemin financiar të një vendi, sepse përmes mbajtjes së këtyre kursimeve në sistemin financiar ato mund të përdoren për investime të ndryshme, si individuale ashtu edhe biznesore”, ka shtuar më tutje profesor Mazreku.

Po sipas tij, tradita e shënimit të kësaj dite është gati njëqind vjeçare dhe tregon rëndësinë që i japin vendet e zhvilluara shënimit të kësaj dite përmes organizimit të evenimenteve të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me edukimin financiar.

“Shtetet e zhvilluara, qysh në hapat e parë të shkollës i edukojnë fëmijët se si të kursejnë. Tradita dhe kultura e kursimit qysh në moshë të re krijon një kulturë e cila përcillet edhe në moshë të pjekur”, ka thënë ai.



# BALIJA: EDUKIMI FINANCIAR, MUNDËSI E MIRË PËR TA LUFTUAR VARFËRINË

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka theksuar se një prej mundësive të mira për ta luftuar varfërinë dhe për ta rritur mirëqenien ekonomike të qytetarëve është edhe edukimi financiar, i cili, sipas tij, ka për qëllim që gjeneratat e reja të jenë më të përgatitura në menaxhimin e financave të tyre personale dhe për vendimmarrje më të mirë për ekonomitë familjare

**B**renda një periudhe të shkurtër Kosova ka arritur që ta ndërtojë një sistem financiar dhe bankar të mirëfilltë, i cili vazhdon të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit. Por, qëllimi i shtetit më të ri në Evropë duhet të jetë rritja e mirëqenies socio-ekonomike të qytetarëve dhe luftimi i varfërisë. Kështu ka theksuar drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, duke shtuar se një prej mundësive të mira për ta luftuar varfërinë dhe për ta rritur mirëqenien ekonomike të qytetarëve është edhe edukimi financiar, i cili ka për qëllim që gjeneratat e reja të jenë më të

përgatitura në menaxhimin e financave të tyre personale dhe për vendimmarrje më të mirë për ekonomitë familjare.

Sipas tij, është pothuajse e pamundur që një ekonomi familjare, por edhe shtet të zhvillohet vetëm në sja të konsumit, pa pasur edhe investime, ndërsa parakusht për investime janë kursimet.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, bën të ditur se në literaturën e edukimit financiar, në mesatare rekomandohet që një familje të kursej 10% të të ardhurave të përgjithshme në rrethana më

të mira ekonomike, dhe 5% në rrethana më të vështira financiare.

**Dita e fundit e tetorit, përkatësisht 31 tetori, është Dita Ndërkombëtare e Kursimeve, e cila çdo vit shënohet edhe në Kosovë. Si e gjen kjo ditë Kosovën gati dy dekada pas fillimit të punës së bankave në vend?**

**Balija:** Zhvillimi i sistemit financiar është jashtëzakonisht i rëndësishëm për stabilitetin dhe progresin e një vendi. Kosova ka arritur që brenda një periudhe relativisht të shkurtër të ndërtojë një sistem financiar dhe bankar të

# 10%

të të ardhurave të përgjithshme rekomandohet që një familje të kursejë në rrethana më të mira ekonomike.

# 5%

të të ardhurave të përgjithshme rekomandohet që një familje të kursejë në rrethana më të vështira ekonomike.

mirëfilltë, i cili ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në rritjen ekonomike të Kosovës. Në këtë 31 tetor, mund të themi se Kosova ka sfida të shumta para vetes, por ka edhe indikatorë të mirë të cilët lidhen me sistemin financiar, ku shihet një rritje e mirë dhe konstante e depozitave bankare, duke tejkaluar shumën prej 3 miliard euro në vitin 2018. Përveç qëndrueshmërisë së depozitave bankare, Kosova ka ndërtuar edhe një portofol kreditor me performancë shumë të lartë, ku kreditë joperformuese janë më pak se 3% e portofolit të përgjithshëm. Këto aspekte fundamentale të zhvillimit të sistemit financiar e bëjnë atë të qëndrueshëm në aspektet afatmesme dhe krijojnë perspektivën për aspektet afatgjata. Në anën tjetër, sistemi i pagesave në Kosovë është zhvilluar mjaft mirë, krahas nevojave të qytetarëve dhe bizneseve për të kryer pagesa dhe transaksione të shpejta dhe të sigurt, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Përkundër këtyre sukseseve, ajo që Kosova duhet të ketë për qëllim është rritja e shkallës së mirëqenies socio-ekonomike të qytetarëve dhe reduktimi i varfërisë në vend. Një prej mundësive të mira për ta luftuar varfërinë dhe për ta rritur mirëqenien ekonomike të qytetarëve është edhe edukimi financiar, i cili ka për qëllim që gjeneratat e reja të jenë më të përgatitura në menaxhimin e financave të tyre personale dhe vendimmarrjen më të mirë të ekonomive familjare. Pikërisht edukimi financiar është objektiv i Ditës Ndërkombëtare të Kursimeve, të cilën e shënon edhe sektori bankar në Kosovë, përmes aktiviteteve që organizon Shoqata e Bankave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës në vazhdimësi.

**Vlerësohet se Kosova është një shoqëri konsumuese. A kanë filluar gjeneratat e reja ta krijojnë një kulturë të kursimeve?**

**Balija:** Mënyra më efektive për reformimin e një shoqërie është krijimi i shprehive dhe njohurive të reja të gjeneratave të reja. Kosova karakterizohet me një popullatë shumë të re në moshë, e cila ka potencial të jashtëzakonshëm për të qenë konkurrenca në kuadër të shoqërive evropiane. Të rinjtë e Kosovës tanimë kanë qasje më të madhe në informacion dhe janë shumë të aftë për ta përdorur teknologjinë moderne, për të komunikuar dhe atë në disa gjuhë të huaja. Megjithatë, një nga fenomenet e padëshiruara të zhvillimit ekonomik të një vendi shpeshherë është hiper-konsumerizmi, apo konsumi i tepërt i të mirave dhe shërbimeve, gjë që ndikon nega-

tivisht në mundësitë për të kursyer. Nëse në të kaluarën fëmijët e një familje të tërë e kanë përfunduar shkollën fillore me një çantë librash, të cilën shpeshherë e kanë bartur nga fëmija i parë të fëmijët tjerë, tanimë kjo nuk është e pamundur dhe secili fëmijë kërkon që të ketë disa çanta librash dhe t'i ndërrojë ato pothuajse çdo vit. Arsyt kryesore për këtë janë presionet shoqërore që vijnë si rezultat i zhvillimit ekonomik të një vendi dhe rritjes së mundësive për të konsumuar. Rrjedhimisht, në këto rrethana ekonomitë familjare shpeshherë i tejkalojnë mundësitë e tyre financiare dhe i sakrifikojnë kursimet potenciale në kërkim të përmbushjes së nevojave të shumta të krijuara në këto rrethana presionesh shoqërore për hiper-konsum.

#### **KURSIMET, PARAKUSHT PËR INVESTIME**

**Pse është e domosdoshme që edhe qytetarët e Kosovës ta krijojnë një kulturë të kursimeve, si një shprehje për një të ardhme më të mirë të gjithsecilit dhe përpos përfitimeve individuale, çka përfiton shteti i Kosovës nga kursimet e qytetarëve, konkretisht ekonomia e vendit?**

**Balija:** Është pothuajse e pamundur që një ekonomi familjare apo shtet të zhvillohet vetëm në bazë të konsumit, pa pasur edhe investime. Ndërsa, parakusht për investime janë kursimet. Ekonomitë familjare e kanë të pamundur të bëjnë investime në renovime të banimit, blerje të patundshmërisë, apo edhe në sigurimin e edukimit cilësor të fëmijëve pa krijuar një bazë të kursimeve. Sigurisht, përveç të ardhurave që gjenerojnë ata mund t'i realizojnë qëllimet e tyre edhe përmes marrjes së kredive bankare, por edhe për të marrë kredi në shumë raste kërkohet që një pjesë të investimit nga huamarrësi të bëhet me mjete vetanake. Do të thotë që kursimet, siç e theksova më lart, janë parakusht për investime. Ngjashëm është edhe në rastin e zhvillimit ekonomik të një vendi, ku kreditë që bankat u japin bizneseve për ta zgjeruar veprimtarinë e tyre dhe për ta rritur punësimin, e kanë bazën në depozitat e qytetarëve të atij vendi. Prandaj, mund të krijohet edhe korrelacioni që sa më shumë kursime që të kenë qytetarët e një vendi, aq më shumë do të mund të financohet ekonomia e atij vendi. Koncepti i tillë vlen edhe për investimet qeveritare, të cilat bëhen në saje të kursimeve që qeveria arrin të bëjë në fusha tjera, si pagat dhe mëditjet, apo shpenzime tjera

administrative, të cilat kursime pastaj barten dhe alokohen për investime kapitale duke krijuar progres për vendin. Kultura e kursimeve mund të themi që është jetike për një të ardhme më të mirë të gjithsecilit.

**Depozitat e qytetarëve në sistemin bankar të Kosovës kanë kaluar shifrën prej 3 miliardë eurosh, duke u rritur së paku mbi 5% nga viti në vit. A është kjo dëshmi e një shprehje të re të qytetarëve për të kursyer dhe njëkohësisht ruajtje e vazhdueshme e besimit të tyre në sistemin bankar?**

**Balija:** Sektori bankar ka arritur të krijojë një besueshmëri të lartë të qytetarët, duke iu falënderuar krijimit të një rregullative të matur dhe mbikëqyrjes së mirë nga Banka Qendrore e Kosovës, si dhe falë angazhimit të bankave komerciale për të ofruar shërbime cilësore bankare në mirëbesim për qytetarët dhe bizneset në Kosovë. Tanimë bankat kanë krijuar partneritet të ngushtë me bizneset e Kosovës dhe e kanë avancuar mënyrën e të bërit biznes në Kosovë. Po ashtu, shërbimet bankare e kanë lehtësuar jetën e qytetarëve duke ofruar shërbime cilësore dhe të sigurt me një nivel të lartë profesional.

Depozitat vazhdojnë të rriten me ritëm të mirë, megjithatë në një të ardhme të afërt ekonomia e Kosovës do të ketë nevojë edhe për më shumë depozita për përmbushur nevojat e kreditimit në vend. Prandaj, vazhdimi i rritjes së depozitave bankare në vend do të jetë shumë e dobishme për ekonominë tonë.


**Cilat janë përvojat më të mira të qytetarëve nga shtetet perëndimore në lidhje me rëndësinë e kursimeve?**

**Balija:** Nëse kursimet janë parakusht i investimeve, mund të themi se gjenerimi i të ardhurave është parakusht i kursimeve. Me kursime nënkuptojmë dallimin në mes të gjenerimit të të ardhurave dhe shpenzimeve e cila paraqet përqindjen e kursyer nga të ardhurat e përgjithshme. Kjo do të thotë se vendet me të ardhura më të larta arrijnë edhe të kenë kursime më të larta, por jo patjetër pasi që konsumerizmi është shpeshherë shumë i theksuar në vendet me zhvillim të lartë ekonomik. Sipas Global Finance Magazine, Zvicrra (17.8%), Luksemburgu (17.3%) dhe Suedia (15.8%) karakterizohen si shtetet evropiane me përqindjen më të lartë të kursimeve të ekonomive familjare. Në anën tjetër, është interesante që një shtet mjaft i avancuar dhe i zhvilluar si SHBA-të kanë një normë të kursimeve prej vetëm 4.9%.



INTERVISTA

# Kursimet e ekonomive familjare në botë



Në përgjithësi rajoni dhe Evropa në vitet e fundit karakterizohen me norma të ulëta të interesit në depozita. Megjithatë, është e saktë që Kosova ka vazhduar të ofrojë normat më të larta për depozita në krahasim me vendet e rajonit. Kjo është një masë që aplikohet nga bankat, e cila gjithsesi e stimulon rritjen e depozitave në sistemin bankar.



#### **VIJON NË FAQEN 10 VIJON NGA FAQJA 08**

Në literaturën e edukimit financiar, në mesatare rekomandohet që një familje të kursejë 10% të të ardhurave të përgjithshme në rrethana më të mira ekonomike, dhe 5% në rrethana më të vështira financiare. Për ta rritur disiplinën e kursimeve, bankat ofrojnë edhe transfere të automatizuara pa pagesë nga llogaria rrjedhëse në llogarinë e kursimeve, e cila rekomandohet të ekzekutohet menjëherë pas pranimit të pagës nga punëdhënësi në mënyrë që së pari të kursethet e pastaj të shpenzohet.

**Raportohet se mijëra llogari të kursimeve të fëmijëve janë të hapura në sistemin bankar të Kosovës. A është kjo një dëshmi e fillimit të një planifikimi më të mirë të financave nga familjet kosovare?**

**Balija:** Viteve të fundit është rritur edhe mundësia, por edhe informimi i prindërve për hapjen e llogarive bankare për fëmijët e tyre. Bankat ofrojnë llogari të tilla, zakonisht pa pagesë, të cilat ofrojnë një mundësi të mirë për kursime. Duke pasur parasysh që faktori kohë është shumë i rëndësishëm për rritjen e kursimeve, llogaritë bankare të fëmijëve mundësojnë që koha të shkojë në favor të krijimit të një fondi për nevojat e tyre në moshën e shkollimit universitar dhe pasuniversitar, apo edhe për nevoja tjera që mund të kenë ata në të ardhmen.

Sigurisht që ka shumë familje që e kanë informacionin dhe dëshirën, por nuk e kanë mundësinë për të kontribuar në këto llogari dhe kjo mbetet sfidë për Kosovën që ta rrisim mirëqenien ekonomike për të gjithë përmes një dinamike më të madhe ekonomike në vend.

#### **LUFTIMI I INFORMALITETIT I RRIIT DEPOZITAT BANKARE**

A ka hapësirë të rriten edhe më tej depozitat në sistemin bankar, nëse institucionet përkatëse e luftojnë më seriozisht ekonominë informale?

**Balija:** Konsiderohet që shkalla e informalitetit të një vendi është e ndërlidhur me shkallën e parasë jashtë sistemit financiar. Nisur nga kjo, Kosova ka ende një informalitet të lartë dhe sigurisht që çdo reduktim i informalitetit do të ndikonte pozitivisht në rritjen e depozitave në sistemin bankar. Kjo do të kontribuonte që të rriten edhe kapacitetet financuese të sektorit bankar. Një nga mënyrat që ne si sektor bankar i kemi promovuar për të luftuar informalitetin është reduktimi i parasë së gatshme në ekonomi dhe rritja e pagesave elektronike, respektivisht përmes përdorimit më të madh të kartelave bankare dhe shërbimeve e-banking.

**Kosova është ndër shtetet me normat më të larta të interesit në depozita në rajon. A ka ndi-**

#### **kuar kjo gjë në rritjen e depozitave nga viti në vit?**

**Balija:** Në përgjithësi rajoni dhe Evropa në vitet e fundit karakterizohen me norma të ulëta të interesit në depozita. Megjithatë, është e saktë që Kosova ka vazhduar të ofrojë normat më të larta për depozita në krahasim me vendet e rajonit. Kjo është një masë që aplikohet nga bankat, e cila gjithsesi e stimulon rritjen e depozitave në sistemin bankar.

#### **SHTETET PERËNDIMORE I KUSHTOJNË RËNDËSI TË MADHE EDUKIMIT FINANCIAR**

**Si të bëhet edukimi financiar i gjeneratave të reja dhe si veprojnë shtetet perëndimore në këtë drejtim?**

**Balija:** Vendet e perëndimit i kushtojnë rëndësi të madhe edukimit financiar dhe kanë programe të avancuara dhe strategji nacionale për edukim financiar. Në këtë drejtim është punuar edhe nga sektori bankar në Kosovë, së bashku me Bankën Qendrore të Kosovës, ku një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve është duke u organizuar çdo vit. Ajo që mbetet për të ardhmen është që të hartojmë një strategji kombëtare për edukim financiar, ku përveç BQK-së dhe sektorit bankar do të përfshihej edhe Ministria e Arsimit dhe institucione tjera relevante, të cilat kanë ndikim në politikat edukative arsimore të vendit.



# KOSOVA SHËNON “DITËN BOTËRORE TË KURSIMEVE”

Në disa aktivitete të organizuara nga Shoqata e Bankave të Kosovës, si dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK), më 31 tetor është shënuar “Dita Botërore e Kursimeve”. Fëmijët që kanë qenë pjesë e këtyre aktiviteteve u kanë treguar njohësve të sistemit bankar për mësimet që i marrin nga familjarët për të kursyer.

**D**uke u bashkëngjitur në aktivitetin mbarëbotërorë, Shoqata e Bankave të Kosovës përmes aktiviteteve të saj edukativo-arsimore me fëmijë ka shënuar “Ditën Botërore të Kursimeve”. Me moton “vepro mençur, kurse sot”, në Shkollën fillore “Qamil Batalli” në Prishtinë, Shoqata e Bankave të Kosovës e bëri hapjen e Ditës Botërore të Kursimeve. Në fjalimin e tij hyrës drejtori i Shkollës, Liridon Maliqi, iu drejtua nxënësve duke i inkurajuar ata që të kursejnë. Ndërsa, në fjalimin e tij drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, theksoi

rëndësinë që ka edukimi financiar për krijimin e mirëqenies për të gjithë shoqërinë.

## BALIJA I INKURAJOI FËMIJËT QË TË FILLOJNË TË KURSEJNË

Balija i inkurajoi fëmijët që të fillojnë të kursejnë, jo vetëm paratë, por edhe mjedisin, pajisjet e shkollës, etj.

Dita e Kursimeve ka filluar të shënohet shumë vite më parë në Milano të Italisë, dhe kishte për qëllim që ta rris vetëdijen e popullatës rreth rëndësisë së kursimit dhe menaxhimit të parasë. Edukimi

financiar është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjithë, pavarësisht moshës.

Nga ana tjetër, vlerësohet se të marrësh një edukim financiar qysh nga mosha e re është një përparësi e madhe.

Duke pasur parasysh rëndësinë e edukimit financiar, Shoqata e Bankave të Kosovës në kuadër të aktiviteteve të saj për përgjegjësi shoqërore, organizon aktivitete të tilla me qëllim që të krijohet kultura e kursimit të resurseve të cilat i kemi në dispozicion.

Edukimi financiar është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjithë, pavarësisht moshës. Nga ana tjetër, vlerësohet se të marrësh një edukim financiar qysh nga mosha e re është një përparësi e madhe.

DREJTORI I SHOQATËS  
SË BANKAVE  
TË KOSOVËS,  
PETRIT BALIJA



### **VIJON NGA FAQJA 11**

Qëllimi kryesor është fuqizimi i gjeneratave të reja, që ata të marrin njohuri ekonomike-financiare nga ekspertë të sistemit bankar dhe rrjedhimisht të jenë të përgjegjshëm me financat e tyre, duke arritur të kursejnë për planet e tyre në të ardhmen. Roli i sektorit bankar për të ndihmuar në edukimin financiar të gjeneratave të reja është jashtëzakonisht i rëndësishëm, duke kontribuar kështu edhe në krijimin e një shoqërie e cila ka njohuri të mira për parane, menaxhimin e parasë dhe financave personale.

### **NXËNËSEVE U SHPËRNDAHET LIBRI PËR EDUKIM FINANCIAR -**

Përveç ligjëratës në Shkollën Fillore “Qamil Batalli”, Shoqata e Bankave të Kosovës ka bërë shpërndarjen e librit për Edukim Financiar dhe materialeve shkollore për nxënësit e Shkollës Fillore “Dituria” në Shkabaj, si dhe nxënësit e organizatës “The Ideas Partnership” në Fushë Kosovë. Ky aktivitet është organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës, me përkrahjen e bankave anëtare: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, IsBank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen

Bank, TEB Bank dhe Ziraat Bank.

Fëmijët këshillohen se si t'i kursejnë paratë “Asnjëherë mos i shpenzo paratë, para se t'i fitosh ato”. Kjo, por edhe shumë thënie dhe shkrime tjera të punuar nga fëmijët e shkollave fillore janë ekspozuar në ambientet e bankë Qendrore të Kosovës, më 31 tetor të këtij viti, në Ditën Botërore të Kursimeve. Fëmijët u kanë treguar zyrtareve të Bankës Qendrore të Kosovës rreth formave të cilët ata i marrin paratë nga prindërit, apo të afërmit e tyre, derisa këta të fundit i kanë këshilluar fëmijët se si t'i kursejnë ato për t'i shfrytëzuar në një kohë kur më së shumti do të kenë nevojë.

Dafina është njëra nga nxënësit e klasës së pestë të shkollës “Pavarësia” në Prishtinë. Kjo së bashku me shokët e shoqet e klasës i kanë vizituar ambientet e BQK-së. Ajo thotë se nga mësuesja, por edhe nga prindërit është mësuar se si t'i kursej paratë.

“Paratë të cilat mi japin prindërit, apo edhe të afërmit, mendohem t'i kursej aq sa mundem, në mënyrë që ato t'i shpenzoj në një kohë kur kam nevojë më së shumti. Kështu më ka mësuar mësuesja, por edhe familja në shpi”, tregon ajo.

Edhe nxënës të tjerë gjatë bashkëbisedimit me Shkëndije Himajn, koordinatore për Funk-

sione të Përgjithshme në BQK, por edhe zyrtarë të tjerë të Bankës Qendrore të Kosovës, kanë prezantuar opinionet e tyre rreth mënyrës së fitimit dhe më pas të kursimit të parave, ku pjesa dërmuese e tyre kanë treguar se janë informuar mjaftueshëm.


Disa nxënës, si me humor kanë treguar se paratë shkojnë e i marrin nëpër bankomate, e disa të tjerë u thonin atyre se para se t'i marrish, ato duhet të fitohen me mund nga prindërit.

“Para se t'i marrësh, ato së pari duhet t'i kesh. Paratë fitohen më shumë mund nga prindërit, kështu që ne duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm rreth mënyrës së shpenzimit, por edhe mënyrës së kursimit”, thoshte njëri nga nxënësit gjatë bashkëbisedimit me zyrtaret e Bankës Qendrore të Kosovës.

### **HIMAJ: PO BËJMË PËRPPJEKJE MAKSIMALE QË TA AVANCOJMË EDUKIMIN FINANCIAR**

Në anën tjetër, Shkëndije Himaj, koordinatore për Funkcione të Përgjithshme në BQK, u sqaroi atyre rëndësinë e kursimeve dhe impaktin që ato kanë jo vetëm për jetën personale, por edhe për ekonominë e vendit në përgjithësi.

“Ne në BQK, sidomos në vitet e fundit, bëjmë përpjekje maksimale që ta avancojmë edukimin




financiar. Ne konsiderojmë që edukimi financiar është i rëndësishëm të zhvillohet qysh në moshën e re sepse pastaj vendimet që merren për afat të gjatë merren me njohuri të plota”, ka thënë Himaj.

Sipas saj, shumë banka në Kosovë ofrojnë mundësi për kurse për fëmijët, llogari këto që behën nën kujdesin e prindërve.

Himaj ka thënë se nëse sot kurseni shuma të vogla, të cilat mund të duken pak, mirëpo ndër vite ato mund të bëhen shuma të mëdha dhe të shërbejnë për qëllime të mëdha.

“Unë dua që t’i ndaj me ju 3 elemente. Të gjitha informacionet që ju pranoi nga BQK-ja t’i ndani edhe me shokët e tuaj. Elementi i dytë është që ju të na ndihmoni që të dizajnojmë programe për edukimin financiar. Mesazhi i tretë është pesha e kurseve të cilët ju sot i bëni dhe impakti që ato kurse mund të kenë jo vetëm në jetën tuaj private por edhe ekonominë e vendit”, është shprehur ajo.

Banka Qendrore e Kosovës përmes një prezantimi dhe diskutimi me fëmijët, bashkërisht kanë treguar rolin dhe rëndësinë e parasë. Më pas nxënësit përmes vizatimeve kanë projektuar idenë e tyre për kursimet.



# Depozitat kontribuese

Burim kryesor i financimit të aktiviteteve në sektorin bankar vazhdojnë të jenë depozitat, të cilat e kanë arritën vlerën e përgjithshme prej rreth 3.2 miliardë euro dhe kanë shënuar rritje vjetore prej 6.8 përqind.

Sipas Raportit të Stabilitetit Financiar të botuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), në shtator të këtij viti, në qëndrueshmërinë e rritjes së depozitave ka kontribuar kryesisht rritja e depozitave të ekonomive familjare. Njëherësh, depozitat

e ekonomive familjare konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet tjera të financimit dhe janë kontribues i rëndësishëm në stabilitetin e sektorit bankar.

Sektorin bankar po ashtu vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit.


Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të shumicës prej bankave janë depozitat, të cilat në nivelin sektorial tejkalojnë kreditë për 124,5 përqind.

Para tetë viteve, përkatësisht në vitin 2010, sipas

statistikave të Bankës Qendrore të Kosovës, shuma e përgjithshme e depozitave të ekonomive familjare ka qenë rreth 1.3 miliardë euro, derisa tetë vite më vonë kanë arritur në rreth 2.2 miliardë euro. Ndërsa shuma e përgjithshme e depozitave në sektorin bankar, duke i përfshirë këtu edhe depozitat e bizneseve, ka ardhur në rreth 3.2 miliardë euro.

Të gjitha depozitat janë të shpërndara në dhjetë banka komerciale, të cilat operojnë në tregun e Kosovës.

## RRITJA E KONKURRENCËS BANKARE



## RRITJA E DEPOZITAVE TË EKONOMIVE FAMILJARE


# e të stabilitetit bankar

**10 BANKA**  
komerciale

**10 BANKA**  
komerciale

**10 BANKA**  
komerciale

**10 BANKA**  
komerciale



# Shoqata e Bankave të Kosovës informon bizneset rreth sigurisë kibernetike

Në kuadër të muajit botëror për sigurinë kibernetike, Shoqata e Bankave të Kosovës i ka informuar bizneset dhe qytetarët për disa nga rekomandimet për ngritjen e sigurisë kibernetike. Është e kuptueshme se me zhvillimin e teknologjisë informative dhe shërbimeve digjitale, edhe mbrojtja nga sulmet kibernetike bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Sulmet kibernetike janë fenomen global nga të cilat nuk kursehet as Kosova, në veçanti ato i cenojnë bizneset dhe institucionet e ndryshme. Mashtrimet përmes sistemeve kompjuterike mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme, prandaj Shoqata e Bankave të Kosovës i paraqet disa rekomandime për bizneset në mënyrë që ato të mbrohen më mirë nga sulmet kibernetike.

Për ta rritur sigurinë kibernetike rekomandojmë që bizneset dhe organizatat e ndryshme të marrin masa si në vijim:

- T'i sigurojnë sistemet kompjuterike me antivirus - rekomandohet që sistemin operativ ta mbani rregullisht të azhurnuar me përditësimet e fundit, po ashtu patjetër të keni të instaluar AntiVirus dhe atë ta mbani rregullisht të azhurnuar. Gjithashtu, edhe aplikacionet tjera siç janë shfletuesit (Explorer, Firefox, Chrome) t'i mbani të përditësuar;
- Të mos hapen e-maila të dyshimtë apo që nuk u dihet dërguesi. Edhe nëse keni pranuar një e-mail nga ndonjë burim i besueshëm por atë e-mail nuk keni qenë duke

e pritur, rekomandohet që paraprakisht ta kontaktoni dërguesin dhe ta pyesni nëse vërtetë është ai dërguesi i e-mailit. Kjo duhet të bëhet për arsye se mund të ndodh që e-maili i dërguesit është komprometuar dhe mashtruesit/hakerët e përdorin atë e-mail për mashtrimin e të tjerëve;

- Mos e klikoni linkun që vjen në e-mail; shkruajeni ueb adresën e institucionit që dëshironi ta vizitoni në internet në adresën e 'browser'-it tuaj;
- Mos e hapni dokumentin/et e bashkëngjitur në e-mail që dërgohet nga dërguesit e panjohur ose që përmban ndonjë dosje të cilën ju nuk e prisni;
- Duhet të jeni të dyshimtë për personin i cili ka kërkuar nga ju informata të ndjeshme. Mos i dërgoni informatat tuaja personale, në veçanti emrin e përdoruesit, fjalëkalimin dhe informatat e kredit kartelës përmes e-mailit, mesazheve të mediave sociale (Facebook, etj.). Bizneset e ligjshme, sidomos bankat, nuk do t'u kërkojnë përdoruesve që t'i dërgojnë informatat e tyre personale e të ndjeshme përmes këtyre mjeteve.
- Mos kryeni transaksione bankare në kompjuterë të cilëve ju nuk u besoni. Mos përdorni Wi-Fi (lidhje publike të internetit)

kur kryeni ndonjë çështje financiare. Përdorni rrjeta të sigurta, Wi-Fi ose 3G për çdo transaksion të sigurt si e-banking dhe transaksione 'online' me kartela;

- Mos shkarkoni aplikacione nga ndonjë medie, përveç tregjeve të aplikacioneve që ofron pajisja juaj e telefonit mobil;
- Në ditët e sotme, është shumë e rëndësishme që për të ekzekutuar pagesat, detajet e bankës së përfituesit të pranohen në mënyrë më të sigurtë, me qëllim të shmangies së rrezikut të pagesave të falsifikuara. Në këtë kontekst, bizneset duhet të kontrollojnë dhe verifikojnë llogaritë e pagueshme të furnitorëve dhe po ashtu duhet ta marrin faturën origjinale para ekzekutimit të pagesave. Këto janë përgjegjësitë kryesore të biznesit.
- E fundit, por jo më pak e rëndësishme, për të arritur tek ju, sigurohuni që informatat tuaja të telefonit dhe të e-mailit të ruajtura në sistemin bankar të janë gjithmonë të përditësuar.

Si përfundim, ju inkurajojmë që nëse eventualisht hasni në diçka të tillë apo jeni në dijeni se është duke u tentuar të kryhet vepra, ta raportoni rastin në Policinë e Kosovës dhe të drejtoheni te Njësia për Luftimin e Krimeve Kibernetike.

